



ZYRA E PROKURIMIT

Nr 079/2021

Nr. Protokoli: 114/2021

Për:	ALBKOS SAFETY SHPK,
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	28.07.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës **23.07.2021** , të parashtruar nga Operatoret Ekonomik: **ALBKOS SAFETY SHPK**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim , mbushje, mirëmbajtja e paisjeve kundër zjarrit** me Nr. të Prokurimi: **624-21-4368 -1-2-1 & 624-021-105-121** nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e datës **23.07.2021** të parashtruar nga Operatoret Ekonomik:: **ALBKOS SAFETY SHPK**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Furnizim , mbushje, mirëmbajtja e paisjeve kundër zjarrit** kundër sasise tek pershkrimi i cmimit të publikuar krahas me Njoftimin për Kontrate të AK –së, të **09.07.2021** të publikuar në platformen elektronike.
2. *Vërtetohet* Njoftimi për kontrate lidhur me Sasine e vendosur tek Pershkrimi i Cmimeve, i publikuar me datë: **09.07.2021** .
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 23.07.2021 , ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit **Furnizim , mbushje, mirëmbajtja e paisjeve kundër zjarrit** me Nr. të Prokurimi: **624-21-4368 -1-2-1 & 624-021-105-121** kundër sasise tek pershkrimi i cmimit të publikuar krahas me Njoftimin per Kontrate te AK –së, të 09.07.2021 të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se nuk ka bazë për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit public.

Autoriteti kontraktues ka vepruar konform nenit 56.15 te RRUOPP-se, i cili citon: "Kurdo qe Autoriteti kontraktues nuk dine sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët ne baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët."

Andaj, AK ka vepruar mbi bazen e ketij neni per shkak se nuk dine sasine indikative dhe ka vendosur te perdore kriterin me cmimin me te ulet me peshim, duke përcaktuar peshët ne baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve".

Po ashtu, ne nuk e kuptojme shqetesimin tuaj lidhur me keto sasi dhe nuk e kuptojme se pse ne kemi bere shkelje te nenit 1 dhe nenit 7 te LPP-se. Ku keto kushte jane te barabarta dhe nuk ka asnje diskriminim per OE. Qellimi I vetem I ketij kriteri te perdorur eshte qe ne rastin e lidhjes se kontrates publike mos te demtohet asnjera pale dhe te kryhen sherbimet konform nevojave te paraqitura per te cilat AK nuk e dine sasine indikative.

Ju edhe ne kerkesen tuaj per ri-shqyrtim i keni permendur disa pozicione per te cilat konform udhezimeve administrative te pershkruara nga ana juaj, nuk dihet sakte sasia, shembull: servisimi dhe testimi te behet njehere ne gjashte muaj apo me shpeshe, pastaj kontrolli i rregullt i aparateve te pakten nje here ne çdo muaj, etj.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shef i Prokurimit
Afrim BYTYQI

